



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 24.1.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË DOGANËS SË KOSOVËS  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, qershor 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Doganës së Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga Blerim Kabashi (Udhëheqësi Ekipi), Lindita Ajeti dhe Fanol Hodolli (Anëtarë Ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Emine Fazliu.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	9
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	14
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	26
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	27
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak .....	30
Shtojca IV: Letërkonfirmimi .....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetore të Doganës së Kosovës për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 19.10.2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Doganës së Kosovës.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Si theksim të çështjes tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e llogarive të arkëtueshme (borxhet) nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme.

Për më gjerësisht shih pjesën 1.1 të këtij raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Falënderojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore****Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të Doganës së Kosovës (DK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave (MF).

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, si dhe shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore.

### Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa "Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare". Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare vjetore të Organizatave Buxhetore në Kosovë, Zyra Kombëtare e Auditimit është e pavarur nga Dogana dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

---

## **Theksimi i çështjes**

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se shpalosjet e llogarive të arkëtueshme (borxheve) nuk janë plotësisht të sakta dhe të besueshme. Në PFV ishin prezantuar të arkëtueshmet në vlerë prej 42,247,165€, përderisa sipas raportit të sektorit të borxheve vlera e tyre ishte 42,857,266€, me diferencë 610,101€.

## **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Përgjithshëm i Doganës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Doganës.

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

---

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Dogana e Kosovës (DK) kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013;
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Çështjet e ngritura në Memorandumin e Auditimit, të datës 30.11.2016, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga menaxhmenti.

Në PFV ishin të nevojshme disa korrigjime financiare për të cilat kemi dhënë sugjerime për të përmirësuar cilësinë e tyre. Pas sugjerimeve tona, DK-së ka korrigjuar PFV-të para finalizimit të tyre, mirëpo kjo nxjerr në pah mungesën e rishikimit sistematik të PFV-ve, i cili është i nevojshëm për të konfirmuar saktësinë dhe plotësinë e tyre si dhe për të konfirmuar aplikimin e të gjitha kërkesave të tjera për raportim.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

## 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Për çështjen e sipër përmendur jepet rekomandimi:

**Rekomandimi 1** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shpalosjet paraqesin gjendjen e saktë dhe të plotë të të arkëtueshmeve (borxheve). Drejtori i Përgjithshëm po ashtu duhet të sigurojë që përgatitja e PFV-ve për vitin 2017 të përfshijë rishikimin e hollësishëm të draft pasqyrave nga menaxhmenti. Pas sigurimit të kontrolleve në rishikimin e PVF-ve, mund të nënshkruhet dhe dorëzohet deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.



---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për DK-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Në mënyrë të ngjashme, pyetësi i vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një OB të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e pyetësorëve të plotësuar për vet-vlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin tre të këtij raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në DK-ës lidhur me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial pasqyron një situatë pozitive. Kjo gjendje ka reflektuar sepse DK-ës ka zbatuar një numër të rekomandimeve, plotësuar pyetësin e vetë-vlerësimit, ka hartuar listën e rreziqeve si dhe kishte themeluar komitetin për menaxhimin e rreziqeve i cili takohej në baza mujore.

Sa i përket raportimit të brendshëm, drejtorët e sektorëve mbajnë takime të rregullta me Drejtorin e Përgjithshëm, duke raportuar dhe diskutuar për të gjitha aktivitetet e tyre.

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) kishte finalizuar pesë (5) raporte të auditimit, të cilat menaxhmentit i ofruan një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe efektivitetin e tyre.

Megjithatë ende vërehen mangësi në qeverisje brenda DK-së veçanërisht në lidhje me zbatimin e rekomandimeve si dhe plotësimin e legjislacionit sekondar (UA për menaxhimin e të arkëtueshmeve).

---

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2015, ka rezultuar me 17 rekomandime. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, dhjetë (10) rekomandime ishin zbatuar plotësisht, tri (3) në proces dhe katër (4) prej tyre nuk janë zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

---

### Çështja 2 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** DK ka hartuar me kohë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e vitit 2015, si dhe ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve. Mirëpo, edhe me tutje, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk ishin zbatuar dhe kjo ka ndikuar që mangësitë e njëjta të përsëriten nga viti i kaluar. Kjo kishte të bëjë kryesisht me keqklasifikim të buxhetit për projekte kapitale, kthimin e të hyrave si dhe menaxhimin e personelit.
- Rreziku** Mos zbatimi i plotë i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve, vështirësi në përmbushjen e objektivave apo edhe në humbje financiare.
- Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

---

## 2.2 Pyetësoni i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një pyetësor të vet-vlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vet-vlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar secilën komponentë të pyetësorit.

Ne kemi përmbledhur konkluzionet tona për DK-në të cilat së bashku me të gjeturat dhe konkluzionet e nxjerra në auditimet tjera do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të jap koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vet-vlerësimit por do ta jap gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për t'i mbështetur përpjekjet e MF në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Si pjesë e auditimit tonë, i kemi shqyrtuar pyetjet kyçe të pyetësorit të vet-vlerësimit në lidhje me pesë komponentët e tij. Për pyetjet e shqyrtuara kemi vlerësuar se:

- Menaxheret e sektorëve dhe drejtorive ishin pjesë e diskutimeve për planin strategjik 2016-2018. Për të mbështetur zbatimin e kësaj strategjie ishte hartuar edhe Plani i Veprimit si pjesë integrale e Planit Strategjik, ku përcaktohen aktivitetet konkrete, njësitë përgjegjëse organizative dhe afatet e plotësimit;
- Në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuara, DK kishte hartuar listën e rreziqeve ku ishin marrë parasysh burime të jashtme dhe ato të brendshme si dhe ishte themeluar komiteti për menaxhimin e rreziqeve. Roli i këtij komiteti ishte në përmirësimin e kualitetit të kontrolleve doganore dhe në realizimin sa më të mirë të objektivave institucionale;
- Plani i prokurimit ishte përgatitur në përputhje me disponueshmërinë e fondeve buxhetore të miratuara, dhe se i njëjti është dërguar në AQP;
- Informimi si dhe raportimi i të hyrave dhe shpenzimeve kryhej në baza mujore, javore dhe sipas kërkesave të menaxhmentit për vendimmarrje raportohej edhe në baza ditore; dhe
- Monitorimi i arritjes së objektivave dhe analizimi i faktorëve për mos arritjen e tyre, kryhej në baza të rregullta tremujore. Këto raporte ishin narrative dhe paraqitnin gjithë procesin e monitorimit në realizimin e objektivave të organizatës për vitin 2016.

### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

## 2.3 Rishikimet specifike të qeveriseje

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit DK operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.3.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

DK kishte përgatitur planin strategjik 2016-2018. Qëllimet dhe objektivat strategjike të DK-së janë në përputhshmëri të plotë me strategjinë dhe politikat zhvillimore të MF-së dhe Qeverisë së Kosovës, për krijimin e një administrate moderne doganore, avancimin e një sistemi efikas të mbledhjes së të hyrave, lehtësimin e tregtisë legjitime dhe fuqizimin e kapaciteteve për mbrojtjen e shoqërisë. Për të mbështetur zbatimin e kësaj strategjie ishte hartuar edhe Plani i Veprimit si pjesë integrale e Planit Strategjik, ku përcaktohen aktivitetet konkrete, njësitë përgjegjëse organizative dhe afatet e plotësimit. Monitorimi i arritjes së objektivave dhe analizimi i faktorëve për mos arritjen e tyre, kryhej në baza të rregullta tremujore. Këto raporte ishin narrative dhe paraqitnin gjithë procesin e monitorimit në realizimin e objektivave të organizatës për vitin 2016.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

DK është agjenci në kuadër të MF-it, dhe se PFV-të e saj konsolidohen në kuadër të PFV-ve të MF-së. Për të siguruar një menaxhim financiar efektiv nevojitet një proces efektiv i konsolidimit dhe raportimit me kohë. DK ka strukturën e saj organizative, menaxhuese dhe llogaridhënëse dhe se Drejtori i Përgjithshëm raporton te Ministri i Financave në baza mujore.

Sektorët në kuadër të DK-së kanë plane veprimi për implementimin e objektivave të parapara me aktivitetet e tyre operative, dhe njëherë në baza tremujore bëjnë monitorimin apo matjen e arritjes së objektivave të përcaktuara me plan strategjik.

Edhe pse ishte rekomandim nga viti i kaluar, gjatë vitit 2016 DK nuk kishte hartuar Udhëzimet Administrative (UA) lidhur me përshkrimin e vendeve të punës, rregullimin e marrëdhënies së punës si dhe për pagesën e shtesave për rrezikshmëri. Mirëpo në fillim të vitit 2017, menaxhmenti i DK-së kishte hartuar UA përkatëse që rregullojnë çështjet e paraqitura më lart.

**Çështja 3 – Mos finalizimi i UA për menaxhimin e të arkëtueshmeve (borxheve) – Prioriteti i lartë**

<b>E gjetura</b>	Përkundër hartimit të UA, në shumë fusha, DK ende nuk e ka finalizuar UA me të cilin parashihen dispozitat të veçanta për zbatimin e Kodit Doganor dhe Akcize që kanë të bëjnë me procesin e menaxhimit të borxhit doganor (të arkëtueshmeve).
<b>Rreziku</b>	Mos hartimi i UA për menaxhimin e të arkëtueshmeve nuk i ofron siguri menaxhmentit të DK-së se ka vendosur kontrolle efektive sa i përket efikasitet në menaxhimin e të arkëtueshmeve doganore, duke filluar që nga krijimi i tyre, regjistrimi në sistem dhe raportimi i plotë dhe i drejtë financiar për nevoja të menaxhmentit.
<b>Rekomandimi 3</b>	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se departamentet përgjegjëse kanë ndërmarrë veprimet e kërkuara ligjore për hartimin e një UA i cili i përcakton dispozita të veçanta për trajtimin e të arkëtueshmeve (borxheve) doganore.

## 2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sistemi i auditimit të brendshëm është një pjesë kyçe e kontrollit të brendshëm. Ne marrim parasysh fushëveprimin e punës së auditimit të brendshëm dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit. Përveç kësaj, ne i shqyrtojmë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti i lartë si rezultat i punës së kryer nga NjAB dhe KA.

NjAB për vitin 2016 kishte përgatitur planin vjetor sipas të cilit kishte planifikuar dhe realizuar pesë (5) auditime.

Përmes raporteve të auditimit, menaxhmentit i janë ofruar informata të rëndësishme për sistemet e disa departamenteve. Drejtoritë/departamentet që auditohen nga NjAB obligohen të raportojnë në periudha tremujore lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve.

NjAB për punën e saj raporton edhe në NJQHAB përmes raporteve tremujore. Linja tjetër e raportimit është te KA, i cili funksionon në kuadër të MF-së. DK raporton në KA me anë të një përfaqësuesi. KA, gjatë vitit 2016 kishte mbajtur katër (4) takime, në të cilat ishin diskutuar rekomandimet e NjAB-së si dhe rekomandimet e raportit të auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2015. Menaxhmenti i DK-së ka marrë vendim (dt.24.03.2017) për plotësimin e pozites zyrtar i auditimit të brendshëm.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për MFK-në jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy (2), pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimeve njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

DK në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

DK në përgjithësi ka një sistem të dizajnuar mirë dhe funksional në menaxhimin e të hyrave. Në krahasim me vitin e kaluar DK gjatë vitit 2016 ka shënuar rritje në realizimin e të hyrave për 10,5%. Po ashtu edhe realizimi i buxhetit final në 99%, me një përmirësim për 11% në raport me vitin paraprak, paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Megjithatë, veprime shtesë nevojiten lidhur me pezullimin e procedurave import-eksport për subjektet që nuk kanë shlyer obligimet doganore, kthimin e të hyrave, si dhe aplikimin e interesit dhe kamatës në rastet e mos përmbushjes së detyrimeve doganore (taksat doganore) nga ana e subjekteve ekonomike dhe personave fizik. Veprime shtesë nevojiten edhe në menaxhimin e personelit dhe në menaxhimin e projekteve kapitale.

### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara, burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>2</sup>	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>8,545,640</b>	<b>7,924,292</b>	<b>7,838,762</b>	<b>7,597,000</b>	<b>9,076,000</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	8,545,640	7,924,292	7,838,762	7,597,000	9,076,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 621,348€. Ky zvogëlim është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të Qeverisë. Në vitin 2016, DK-ja ka realizuar 99% të buxhet final ose 7,838,762€, me një përmirësim prej 11% krahasuar me vitin 2015.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>8,545,640</b>	<b>7,924,292</b>	<b>7,838,762</b>	<b>7,597,000</b>	<b>9,076,000</b>
Pagat dhe Mëditjet	5,566,985	5,587,295	5,587,296	5,247,000	5,388,000
Mallrat dhe Shërbimet	1,735,280	1,645,764	1,565,043	1,913,000	2,588,000
Shërbimet komunale	193,375	101,312	96,595	92,000	146,000
Investimet Kapitale	1,050,000	589,921	589,828	345,000	954,000

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Me rishikim të buxhetit dhe me vendime të Qeverisë kategoria e pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 20,310€. Në këtë kategori ishte realizuar 100% e buxhetit final;
- Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 89,516€. Me rishikim të buxhetit kjo kategori ishte zvogëluar për 19,516€, me vendim të Qeverisë në muajin tetor ishte zvogëluar buxheti edhe për 100,000€, si rezultat i transferimit në ATK. Ndërsa në fund të vitit me vendim të Qeverisë buxheti ishte rritur për 30,000€;
- Buxheti final për shërbime komunale ishte zvogëluar për 92,063€. Fillimisht, me rishikim të buxhetit ishte zvogëluar për 60,063€, ndërsa më pas, me vendim të Qeverisë ishte zvogëluar edhe për 32,000€; dhe

<sup>2</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

- Edhe buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogluar për vlerën 460,079€. Me rishikim të buxhetit kjo kategori ishte zvogluar për 414,000€, ndërsa me pas me vendime të Qeverisë për 46,079€.

**Tabela 3. Te hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës - realizmi ndaj buxhetit (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi	2014 Realizimi
Te hyrat bruto	1,005,100,000	1,040,100,000	1,051,419,000	951,808,000	870,978,222
Kthimet	(7,400,000)	(8,700,000)	(7,377,000)	(6,879,000)	(2,407,787)
<b>Te Hyrat neto</b>	<b>997,700,000</b>	<b>1,031,400,000</b>	<b>1,044,042,000</b>	<b>944,929,000</b>	<b>868,570,435</b>

DK në vitin 2016, kishte realizuar të hyra për 99,611,000€ (10.5%) më shumë se në vitin 2015. Rritje më të madhe kemi tek grumbullimi i TVSH-së në kufi prej 57,943,000€ apo 13% në raport me 2015 si dhe te akciza në kufi prej 41,046,000€ apo 12% më lartë se në vitin 2015.

Kjo rritje e të hyrave në vitin 2016 ishte rezultat i ndërmarrjes së veprimeve nga menaxhmenti i DK-së, në forcimin e kontrolleve duke rezultuar me veprime shtesë në uljen e informalitetit si dhe veprimet anti kontrabandë.

#### Çështja 4 - Keq-klasifikimi i buxhetit - Prioriteti i lartë

**E gjetura** Sipas nenit të 3 rregullës financiare 02/2013 – për menaxhimin e pasurive jo financiare – Pasuri kapitale nënkupton të gjitha pasuritë jo financiare që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vitë, vlerë financiare mbi 1,000€ dhe pronësi dhe kontrolli mbetet nga organizata.

Pagesa në vlerë prej 16,258€ për “Furnizim me pajisje të IT-së” është kryer nga kategoria e investimeve kapitale. Megjithatë, këto furnizime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime pasi vlera e tyre për pajisje nuk e kalon vlerën mbi 1,000€.

**Rreziku** Paraqitja jo e saktë e të dhënave në pasqyra financiare shpie në një keqkuptim të aktiviteteve financiare të DK-së. Mos raportimi i drejtë zvogëlon efektivitetin e kontrolleve menaxheriale, si dhe ndikon në mbivlerësimin e njëres kategori dhe nënvlerësimin të kategorisë tjetër.

**Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar linjat raportuese, në mënyrë që planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara të bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga MF-ja.



---

**Çështja 5 - Mos respektim i procedurave buxhetore - Prioritet i lartë**

- E gjetura** Ligji i buxhetit për vitin 2016, përcakton lëvizjen e mjeteve të alokuara nga një projekt kapital (Tabela 3.2) në tjetrin brenda nën programit të njëjtë të OB-së. Nëse kërkesa për alokime është mbi 25% të shumës së buxhetuar atëherë kërkohet aprovimi nga Kuvendi.
- Me rishikim të buxhetit dhe me vendim të Kryeministrit mjetet për projektin *“Furnizim me harduer dhe pajisje të TI-së”* ishin 136,847€. mirëpo pagesa e bërë për këtë projekt ishte në vlerë prej 197,187€, me rastin e transferimit të mjeteve në vlerë prej 60,340€ nuk ishte respektuar procedurat e ligjit të buxhetit për transferimin e buxhetit prej një projekti në projektin tjetër në kuadër të DK, shuma e këtyre mjeteve arrinë 44% e totalit të projektit.
- Rreziku** Planifikimi jo i duhur i buxhetit për projekte të caktuara si dhe pagesa e tyre shumë më e lartë se mjetet e ndara, ndikon në uljen e transparencës dhe rrezikon realizimin e projekteve të përcaktuara në tabelën e buxhetit ku me këtë edhe realizimin e objektivave të organizatës.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka instaluar kontrole shtesë në fazën e buxhetimit dhe të monitorimit të realizimit të projekteve, për të mundësuar më pas, regjistrimin dhe raportimin e shpenzimeve në pajtueshmëri me kërkesat për raportim.

### 3.1.1 Të hyrat

DK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave. Të hyrat e planifikuara nga Qeveria e Kosovës për vitin për vitin 2016 ishin 1,040,100,000€, përderisa të hyrat bruto të realizuara ishin 1,051,419,363€, për vitin 2016 Dogana kishte tejkaluar planin vjetorë për 11,319,363€ apo në masën prej 1%.

**Tabela 4. Të hyrat e inkasuar/ kthimet për buxhetin e Kosovës - sipas kodeve ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Kodet ekonomike	Shuma 2016	Shuma 2015
Akciza në kufi	40410	390,905,186	349,876,450
Akciza e brendshme	40430	12,374,036	10,756,400
Dogana në import	40450	129,931,679	131,390,851
TVSH në kufi-dogana	40460	514,339,311	456,518,488
Tatimet e taksa. tjera nga dogana	40470	548,759	153,228
Kundërvajtje e dënime doganore	50105	906,347	938,760
Të hyrat nga shitja e mallrave	50403	198,689	313,039
Banderolat	50412	382,567	508,057
Kontrolle e jashtëm doganore	50511	1,832,084	1,353,172
Fast-dogana	50512	707	-
Kthimi i akcizës	40440	-5,758,537	-4,783,372
Kthimi i taksës doganore	40451	-489,407	-370,704
Kthimi i TVSH-së	40461	-1,094,227	-1,223,579
Kthimi taksa tjera doganore	40471	-34,756	-500,923
	<b>Të hyrat neto</b>	<b>1,044,042,436</b>	<b>944,929,867</b>

---

**Çështja 6 - Mos respektimi i ndalesave për kryerjen e procedurave import/eksporte -Prioritet i lartë**

**E gjetura** Drejtori i DK-së konform kompetencës ligjore të deleguar nga Drejtori i ATK-së me nr. ZDP-14/2014 për subjektet të cilat janë aktive dhe kanë obligime të taksës së doganës dhe TVSH-së, duhet të merr vendim që të ju ndalohet zhvillimi i procedurave eksport-importe.

Ndaj një subjektit ishte lëshuar aktvendimi, sipas të cilit ishte obliguar që në afat prej dhjetë (10) ditësh të paguaj obligimin prej 489,762€, ose të bëjë programim të borxhit, në të kundërtën do t'i ndalohet zhvillimi i procedurave eksport-import. Auditimi ynë shpalosi se edhe pse ky subjekt nuk kishte kryer obligimet dhe nuk kishte bërë marrëveshje për ri-programim të borxhit, kishte realizuar eksporte-importe gjatë gjithë vitit 2016.

**Reziku** Mos ndërmarrja e veprimeve konkrete për ndalimin e zhvillimit të procedurave eksport-importe, ndikon në pamundësinë e inkasimit të të arkëtueshmeve si dhe në trajtimin jo të barabartë në raport me subjektet tjera ndaj të cilave është pezulluar e drejta për eksport-importe.

**Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të forcojë kontrollet për të siguruar se janë duke u respektuar të gjitha procedurat e përcaktuara ligjore. Në këtë aspekt, të sigurojë që subjekteve të cilat nuk paguajnë obligimet, ose nuk hyjnë në marrëveshje për ri-programim të borxhit t'i ndalohet eksport-import i mallrave dhe shërbimeve.

**Çështja 7 - Kthimi i mjeteve - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Gjatë vitit 2016, numri i aktvendimeve lidhur me kthimin e mjeteve nga taksat doganore ishte 283 lëndë dhe në vlerë totale prej 858,726€. Këto aktvendime janë kryer nga degët dhe sektorët e ndryshëm të DK-së, të cilat ishin rezultat i parashtrimit të kërkesave nga subjektet ankimore lidhur me taksat e ngarkuara nga DK-ja.

Prej tyre, 84 lëndë në vlerë prej 675,435€, janë për kthimet nga bankat komerciale, të cilat ndodhin për shkak të gabimeve në transfer nga bankat komerciale apo pagesave të dyfishta si dhe 106 lëndë në vlerë prej 183,291€ nga sektori për rishikim të vendimeve.

**Rreziku** Kontrollat jo efektive gjatë vlerësimit të importeve si dhe ekzekutimi i pagesave të dyfishta nga bankat komerciale kanë rezultuar me një numër të konsiderueshëm të ankesave nga subjektet ankimore. Këto kanë për pasojë mos inkasimin e duhur të të hyrave dhe njëkohësisht edhe humbjen e kredibilitetit të institucionit.

**Rekomandimi 7** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle shtesë, si dhe të rrisë nivelin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në zhvillimin e procedurave doganore (përcaktimin e vlerës së importeve). Në këtë mënyrë do të eliminohet mundësia për gabime në vlerësimet doganore, si dhe do të reduktohet dukshëm numri i ankesave.

**Çështja 8 - Vonesa në dërgimin e lëndëve në Thesar nga sektori i financave - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Sipas neni 4 të UA.nr 05/2015 për rregullimin e procedurës së kthimit të taksës së akcizës, kërkesa për kthim të taksës së akcizës e paguar për produktin akcizore (lëndë djegëse) të përdorura në procesin e prodhimit, sektori i akcizës pas aprovimit të kërkesës për kthim të taksës së akcizës, lëndën e dërgon te sektori i financave, i cili brenda dy (2) ditëve të punës këto lëndë duhet t'i dorëzojë në Thesar për pagesë.

Gjatë testimit të 11 mostrave, konstatuam se në nëntë (9) prej tyre kishte pasur vonesa në dërgimin lëndëve në Thesar. Vonesat ishin deri në 15 ditë.

**Rreziku** Vonesat në kthimin e taksave të akcizës ndikojnë në efikasitetin e zbatimit të legjislacionit, ndërsa për kompani mund të rezultojë me kufizim të burimeve financiare dhe vështirësi buxhetore në realizmin objektivave të tyre.

**Rekomandimi 8** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë kontrolle shtese në mënyrë që të respektohen të gjitha kërkesat ligjore. Kërkesat e subjekteve për kthimin e taksës së akcizës duhet të dërgohen në Thesar për pagesë brenda afatit të përcaktuar ligjor.

### 3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollat kyçe në këtë proces kanë dëshmuar plotësinë dhe saktësinë e të dhënave të prezantuara në PFV-të e DK-së. Në këtë kategori ishin shpenzuar 99% të buxhetit final.

Në raportin e auditimit për PFV-të e DK-së, për vitin 2015, ne kemi identifikuar disa çështje si: mbulimi i pozitive me Ushtrues Detyre (UD) për periudhë më të gjatë se kërkesat ligjore, mos përditësimi i kontratave të punës në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësit në punë, aprovimi i pushimit pas shfrytëzimit, si dhe pagesa e shtesave për rrezikshmëri pa bazë të qartë ligjore. Lidhur me këtë ne rekomanduam Drejtorin e Përgjithshëm për forcimin e kontrolleve në këtë drejtim.

DK, kishte zbatuar disa çështje në fillim të vitit 2017, si: përditësimi i kontratave të punës dhe hartimi i UA nr.01/442/2016, për pagat, shtesat dhe shpërblimet e zbatueshme në kuadër të DK-së, andaj ne nuk i kemi përfshirë si të gjetura në këtë raport. Megjithatë ne identifikuam se gjatë vitit 2016 një numër i madh i pozitive ishin mbuluar me UD.

---

**Çështja 9 – Numri i lartë i mbulimit të pozitive me ushtrues detyre - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Drejtori i Përgjithshëm në vitin 2014 kishte aprovuar UA nr.11/2014, në të cilin ishin paraqitur ndryshimet dhe plotësimet e UA nr.91/2010 mbi rregullat dhe procedurat e rekrutimit, zhvillimit dhe administrimit.

Ndër ndryshimet më të shprehura ishte neni 40 - pika 3.A që në rast të mos përmbushjes së pozitës së caktuar, atëherë drejtori mund që të zgjasë emërimin e përkohshëm deri në plotësimin e pozitës së lirë pa saktësuar periudhën kohore të mbulimit të pozitive me UD.

Në vitin 2016, në DK ishin 26 pozita menaxhuese të mbuluara me UD. Prej tyre një (1) pozitë që nga viti 2008, dhjetë (10) pozita për më shumë se dy vite, nëntë (9) pozita për më shumë se një vit, dhe gjashtë (6) pozita për më shumë se gjashtë muaj. Për të gjitha këto vazhdime kishte vendime përkatëse.

Me tutje, Zyrtari në pozitën e këshilltarit të Drejtorit të Përgjithshëm (DP) me vendime emërohet përkohësisht në mbulimin e tri (3) pozitive tjera si: Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Operacionale, Udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Politikash, dhe Udhëheqës i TI-së dhe Procedurave të kompjuterizuara Doganore.

**Rreziku** Mbulimi i pozitive të rëndësishme me UD për një kohë kaq të gjatë, rrit rrezikun që performanca e realizuar dhe përgjegjësia në këto pozita të mos jetë në nivelin e kërkuar. Po ashtu, angazhimi në mbulimin e disa pozitive njëkohësisht, ndikon në uljen e cilësisë në kryerjen e obligimeve si dhe rrezikon arritjen e objektivave të përcaktuara.

**Rekomandimi 9** Drejtori i Përgjithshëm duhet të përcaktojë me UA, një afat të arsyeshëm kohor për mbulimin e pozitive me UD, dhe të sigurojë se procedurat e rekrutimit fillojnë më kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar. Gjithashtu të sigurojë se bëhet ndarje e duhur e detyrave dhe përgjegjësive për të arritur objektivat e DK-së.

### 3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime, përfshirë edhe buxhetin për shërbime komunale për vitin 2016 ishte 1,747,000€. Prej tyre ishin shpenzuar 1,662,000€, ose 95%. Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë të bëjnë kryesisht me furnizimin me banderolla, karburante si dhe mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve. Në këtë kategori testuam pesë (5) aktivitete të prokurimit me vlerë totale 605,199€, si dhe gjashtë (6) pagesa në shumë totale 203,721€. Testet tona në këto kategori nuk kanë identifikuar ndonjë parregullësi.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.1.4 Investimet kapitale

DK ka përgatitur planin paraprak dhe atë final të prokurimit, dhe të njëjtat janë dorëzuar me kohë në Agjencinë Qendror të Prokurimit.

Buxheti final për investime kapitale ishte 590,000€, i cili ishte realizuar në tërësi. Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar shtatë (7) pagesa në vlerë 457,209€ si dhe tri (3) procedura të prokurimit.

#### Çështja 10 - Kryerja e pagesës në mungesë të kontratës valide - Prioritet i lartë

**E gjetura** DK posedon softuerin "ASYCUDA", për menaxhimin e të hyrave. Pagesa e kështit të gjashtë (6) në vlerë prej 93,202€ për zhvillimin e moduleve të tij, ishte bërë me datë 09.03.2016, bazuar në aneks kontratën e cila kishte skaduar me 30.09.2015, përkatësisht pas pesë (5) muajve. Vonesa në pagesë ishte rezultat i mungesës së buxhetit në vitin 2015.

**Rreziku** Kryerja e pagesave jashtë afatit të kontratës, paraqet anashkalime ligjore dhe kërkon buxhet shtese në raport me kontratat e lidhura. Për me teper mund t'i ekspozohet rrezikut për pagesë të ndëshkimeve të mundshme si rezultat i mos përmbushjes së kushteve kontraktuale.

**Rekomandimi 10** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet në menaxhimin e kontratave, si dhe të sigurojë se të gjitha pagesat bëhen konform afateve të parapara me kontratë.

## 3.2 Pasuritë

### 3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik. Udhëzuesi kryesor në këtë fushë është rregullorja nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

Vlera e pasurive jo financiare kapitale me vlerë mbi 1,000€ e paraqitur në PFV ishte 4,768,000€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale nën 1000€ ishte 254,580€.

#### Çështja 11 - Mos përdorimi i sistemit e-pasuria - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Përkundër rekomandimit të dhënë në raportin e vitit paraprak, për të përmirësuar menaxhimin e pasurive nën 1,000€, duke i evidentuar në softuerin e-pasuria, edhe me tutje gjendja ishte e njëjte. Pasuritë jo kapitale dhe stoqet nuk i kishte menaxhuar përmes softuerit e-pasuria, mirepo ato janë evidentuar dhe raportuar përmes një sistemi të brendshëm të tyre.

**Rreziku** Mos menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1000€ përmes sistemit e-pasuria si dhe regjistrimi i pasurive në databaza të ndryshme vështirësojnë menaxhimin efektiv të tyre. Dhe se kjo gjendje mund të ndikoj në prezantimin jo të saktë dhe jo të plotë të pasurive.

**Rekomandimi 11** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që pasurit jo kapitale regjistrohen dhe menaxhohen përmes sistemit e-pasuria.

### 3.2.2 Llogaritë e arkëtueshme (borxhet)

DK ka vendosur një sistem të kontrollit të brendshëm që mbikëqyrë procesin e arkëtimit të të hyrave (funksionalizimi i sistemit elektronik Nuxeo për të arkëtueshme), megjithatë edhe më tutje vlera e lartë e të arkëtueshmeve është shqetësuese. Menaxhmenti duhet të marrë veprime shtesë për të forcuar kontrollet në mënyrë që vlera e tyre të ulet në një shkallë të pranueshme.

Sipas sektorit për Mbikëqyrje të Transitit, Garancit dhe kontabilitetit Doganor/Borxhit (SMTGKB), të arkëtueshmet në fund të 2016 ishin në vlerë prej 42,857,266€.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 05/L-043 për faljen e borgjeve publike, DK ka përgatitur dhe ka dërguar listat për faljen e borgjeve në MF. Sipas listës për falje të borgjit për subjekte juridike dhe persona fizik shuma e borxhit të falur për vitin 2016 ishte 2,980,908€.

Ndaj subjekteve të caktuara të cilat ishin me vonesë në kryerjen e obligimeve ndaj DK-së, gjatë vitit 2016 nuk ishte aplikuar asnjë interes, siç është përcaktuar në Kodin Doganor dhe Akcizë. Për të



---

gjitha këto subjekte, nga zyrtarët e sektorëve përkatëse të DK-së janë lëshuar aktvendime për inkasim të të arkëtueshmeve.

Më tutje në fillim të vitit 2017 menaxhmenti i DK-së kishte marrë vendim për aplikimin e interesit në rastet kur subjektet nuk i shlyejn obligimet doganore konform kërkesave të Kodit Doganor.

---

### Çështja 12 – Menaxhim jo efikas i llogarive të arkëtueshme - Prioritet i lartë

**E gjetura** Trajtimi i të arkëtueshmeve vazhdon të mbetet sfidë për DK-në. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrur shkaktarët e dështimit të subjekteve në pagesën e të arkëtueshmeve të caktuara nga Dogana ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre dhe se vlera e e lartë e tyre nga viti në vit vazhdon të mbetet shqetësuese.

**Rreziku** Mungesa e veprimeve të mjaftueshme për inkasim të të arkëtueshmeve publike mund të mos i inkurajon subjektet tjera që ti paguajnë obligimet e tyre me kohë. Vjetërsia e të të arkëtueshmeve e vështirëson mbledhjen e tyre.

**Rekomandimi 12** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka forcuar kontrollet në menaxhimin e të arkëtueshmeve, rritjen e efikasitetit si dhe forcimin e kontrolleve në menaxhimin dhe arkëtimin e tyre. Në këtë aspekt, të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve në mënyrë që të ndërmerren veprimet ligjore për inkasimin e tyre.

### 3.2.3 Obligimet

Pasqyra e obligimeve në fund të vitit 2016 ishte në vlerë prej 3,829€. Ne testuam raportet mujore të obligimeve si dhe pesë (5) fatura të obligimeve të prezantuara në PFV. Testet tona në këtë kategori shpalosen se menxhimi dhe raportimi i obligimeve ishte bërë në pajtueshmeri me legjislacionin.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.1 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.4 Pajteshmeria me PVF dhe kërkesat tjera te Raportimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve i adreson dobësitë e identifikuara në PVF plotësisht. - Deklarata e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në Qeveri duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.			Nuk janë marrë masa.
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit		Një numër i konsiderueshem i rekomandimeve ishte zbatuar mirëpo edhe më tutje kërkohen veprime shtesë për zbatim të plotë.	
2.4.Lista kontrolluese e vetvlerimit të MFK-së	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetvlerësimit duke i përfshirë rreziqet potenciale në dokumentin e rreziqeve. Duhet të aplikohet një mekanizëm i rishikuar për ta konfirmuar plotësinë e listës kontrolluese si dhe për të siguruar dokumentacionin mbështetës.	Po		

2.5.1 Menaxhimi i rrezikut	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se do të ndërmer veprime konkrete për përfshirjen e llogarive të arkëtueshme në dokumentin për menaxhimin e rrezikut, me qëllim të identifikimit, monitorimit dhe uljes së tyre në një nivel të pranueshëm.	Po		
2.5.2 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj përmes Komitetit të Auditimit se Njësia e Auditimit të Brendshëm e përmbush planin vjetor duke i dhënë prioritet auditimeve të rëndësishme.	Po		
2.5.2 Sistemi i Auditimit të Brendshëm	Drejtori i Përgjithshëm, në dakordim me Drejtorin e NJAB-së të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave që pozita e caktuar të mbulohet me zyrtar kompetent dhe profesional.	Po		
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet ti analizoj më tutje arsyet realizimit të ulët të buxhetit të identifikuar në këtë pjesë të raportit dhe të marr në konsideratë mundësinë për fillimin e hershëm të procedurave të prokurimit për t'i parandaluar sfidat të cilat paraqiten gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve të prokurimit.	Po		
3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se planifikimi dhe klasifikimi i projekteve të caktuara bëhet duke pasur për bazë planin kontabël të aprovuar nga Ministria e Financave			Nuk janë marrë masa.

3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaktarët për mos dhënien e shënimeve sqaruese me rastin e mos harmonizimit të shënimeve të kontabilitetit të DK-së me të hyrat e regjistruara në SIMFK. Kjo duhet të bëhet me qëllim që t'i mundësoj menaxhmentit të DK-së të merr vendime bazuar në informatat e sakta dhe të plota.	Po		
3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me MAP-in duhet të siguroj përditësimin e TARIKUT në afate të rregullta kohore me qëllim të reflektimit të ndryshimeve të normave për taksim. Kjo duhet të bëhet në mënyrë që produktet të klasifikohen dhe të ngarkohen me taksa konform normave të përcaktuara me vendime të Qeverise dhe mekanizmave përkatëse.	Po		
3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të përforcoj kontrollet për të siguruar kalkulimin e saktë dhe në pajtueshmëri me kornizën ligjore të shpenzimeve të transportit.	Po		
3.4 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë forcuar kontrollet rreth përcaktimit të vlerës së importeve, në mënyrë që të eliminohet aq sa është mundur mundësia për parashtrimin e ankesave nga subjektet ankimore.			Nuk janë marrë masa.
3.5 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se me rastin e nënshkrimit të kontratës çmimet e kontraktuara duhet të jenë të njëjta me kontratën paraprake.	Po		
3.5 Prokurimi	Drejtori i Përgjithshëm ne te ardhmen duhet të siguroj që ndryshimet tatimore të përcaktuara me ligjin e ri të TVSh-së inkorporohen në të gjitha kontratat e prokurimit si dhe pagesat të procedohen sipas normave të reja të TVSh-së.	Po		



3.6.1 Paga dhe mëditje - mangësi sistematike ne menaxhimine burimeve njerzore	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitive të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj bazën e qartë ligjore lidhur me pagesën e rrezikshmërisë për personelin përbrenda institucionit si dhe marrjen e vendimeve me kohë për të evituar pushimet pa pagesë pa aprovime paraprake. Po ashtu, duhet të siguroj përditësimin e dosjeve të personelit në pajtueshmëri me detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i ushtrojnë.			Nuk janë marrë masa.
3.7.1 Pasurit kapitale dhe jo kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerr veprimet e duhura që pasuritë të klasifikohen saktë në regjistrin kontabel dhe në programin e-pasuria, në mënyrë që vlera financiare e raportuar në raporte të jetë e plotë dhe e saktë.		Pasuria kapitale që ka të bëjë me implementimin e sistemit ASYCUDA ishte regjistruar nga investimi në vijim në kategorin përkatëse, ndërsa menaxhimi i pasurive jo kapitale nën 1,000€ vazhdon të mos menaxhohet përmes sistemit e-pasuria.	
3.7.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj se ka ndërmarr masa të duhura për funksionalizimin e sistemit me qëllim të evidentimit të të gjitha borxheve në sistemin NUXEO. Më tutje, duhet të vazhdoj të ndërmarr veprimet ligjore si dhe të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve.		Është funksionalizuar sistemi NUXEO dhe se të gjitha borxhet regjistrohen përmes tij, mirëpo edhe më tutje kemi konstaruar se janë ndërmarr veprime për pezullimin e aktiviteteve për subjektet të cilat kishin borxhe ndaj Doganës.	

## Shtojca IV: Letërkonfirmimi




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave  
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs



REFERENCË:		Nr.i Dokumentit:24.1.1-2016-06			
PËR/ZA/TO:		Emine Fazliu - Udhëheqëse e Departamentit të Auditimit Zyra Kombëtare e Auditimit			
CC:		Blerim Kabashi-Udhëheqës i Ekspertit të Auditimit-ZKA Valbon Bytyqi -Ndihmës Auditor i Përgjithshëm			
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Bahri Berisha - Drejtor i Përgjithshëm - Dogana e Kosovës			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Letër e Konfirmimit Draft Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare të Doganës së Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2016			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	Drejtoria e Doganës, Lagjja	Data:	25.05.2017
Br. kancelarije:		Kucni:	Kalabri, Rr. Rexhep Krasniqi	Datum:	
Room No.:		Extension:	10.000 Prishtinë,	Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/for action					
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/for approval					
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/for signature					
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/for comments					
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/may we discuss					
VËMENDJA JU AJ/ VASA PAZNJA/your attention					
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/as discussed					
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/as requested		x			
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/for your information		x			
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar Draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2016 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- Pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Bahri Berisha, .....  
Drejtor i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës.  
Data: 25.05.2017, Prishtinë

